

KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL SH.A.

Nr. 76

Dt. 28. 10. 2011



Zyret Qendrore

Rr. Gazmend Zajmi 5 30000 Pejë-Kosovë
Telefoni: +381 (0)39 432 355
www.hidrodrini.com

Bordi i Drejtorëve i KUR "Hidrodrini" SH.A-Pejë, konform Rregullores së brendshme të kompanisë Mbi Marëdhënjen në Punë, e bazuar në Ligjin e Punës në Kosovë Nr. 03L-212, si dhe Udhëzimit Administrativ nr 09/2010 për Tatimin në të Ardhurat Personale të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, nxjerr këtë:

RREGULLORE Mbi Kompenzimin e benificioneve dhe të ardhurave tjera e të punëtorve të KUR."Hidrodrini"SH.A.

Neni 1.

Dispozitat e përgjithshme

Me ketë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, procedurat dhe lartësia(vlera)e shpenzimeve të parasë në K.R.U."Hidrodrini" SH.A. -Pejë për ; Paga, udhëtime për qëllime zyrtare, gradime profesionale dhe ndihma solidare, trajnimimet dhe shkollimi.

Neni 2.

Paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera

1. I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me Ligjin e punës Nr.03/L-212, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Kompanisë.
2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe për kohën e kaluar në punë dhe rezultatet të punës, të përcaktuara me Kontratën e Punës.
3. Punëdhënësi duhet t'i paguajë femrave dhe meshkujve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera.

Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve. Pagat mund të paguhen përmes transferit bankar ose me para të gatshme me ç'rast punëdhënësi duhet të mbajë regjistrin për pagesat e bëra.

Pagat në Kosovë paguhen sipas valutës zyrtare në Euro (€).

Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj.

Neni 3.

Pagat në bazë të suksesit në punë

Bazat për përcaktimin e suksesit në punë janë: sasia, cilësia, ekonomizimi në punë, kreativiteti dhe inovacionet. Suksesi në punë matet gjegjesisht vlerësohet për individin ose në mënyrë grupore sipas kritereve të përcaktuara paraprakisht të njohura për punëtorët para fillimit të kryerjes së punës.

Neni 4.

Paga shtesë

1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me , Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

20 % në orë për kujdestari;

30 % në orë për punë gjatë natës;

30 % në orë për punë jashtë orarit;

50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe

50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra- tjetrën.

I punësuari mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij nenit,kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi.

Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi,në përputhje me përqindjet e parapara në paragrin 2. të këtij nenit. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të Kompanis.

Punëtorëve ju njihet e drejta e shtesës për përvojë në punë 0,5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës në punë.

7. Shuma e kompenzimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës punëtorit i njifet në vlerë 2. 5 Euro për ditë pune.

Neni 5.

Kompensimi i pagës

1. I punësuari ka të drejtë për kompensim në pagë, në rastet si në vijim:

1.1 gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet;

1.2 gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor;

1.3. gjatë aftësimit dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar,

dhe

1.4. gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet.

Neni 6.

Kompensimi i pushimit mjekësor

1.I punësuari në rast të sëmundjes ka të drejtë në pushim mjekësor të rregullt mbi bazën, deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % të pagës.

2.I punësuari ka të drejtë në pushim mjekësor pa pagesë sipas nenit 40 te Ligjit të punës, edhe për raste tjera.

3.I punësuari ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor që është si pasojë e lëndimit ose sëmundjes profesionale në punë e cila ndërlidhet me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për punëdhënësin me kompensim prej 70 % të pagës së tij.

4.I punësuari ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor sipas paragrafit 3 të këtij neni në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune.

5.Pagesa për kompensimin e pushimit mjekësor bie mbi punëdhënësin.

6.Të drejtat e përcaktuara sipas këtij neni mund të parashihen edhe me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm, por në asnjë rast nuk duhet të janë më të ulëta se sa të drejtat e parapara me këtë ligj.

7.Dispozitat e këtij neni do të janë të aplikueshme deri në kohën e hyrjes në fuqi të legjislacionit përmes mbrojtjen dhe kujdesin shëndetësor.

Neni 7.

Kompenzimi i pushimit të lehonisë

Femra e punësuar gjëzon të drejtën prej dy mbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë.

Me prezantimin e certifikatës mjekësore femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në dyzetepesë (45) ditë para datës kur pritet të lindë. Në periudhën prej njëzetetë (28) ditëve para datës kur pritet të lindë, punëdhënësi me pëlqimin e femrës shtatzënë, mund të kërkojë që ajo ta fillojë pushimin e lehonisë, nëse punëdhënësi mendon se femra e punësuar nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e saj.

Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë.

4. Tre (3) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë .

5. Femra e punësuar ka të drejtë me këtë ligj që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muajt të tjera pa pagesë.

Neni 8.

Kompensimi i lëndimit në punë

1 . Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas Ligjit të punës dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

2. Ministria e punës dhe mirëqenies sociale nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar shtrirjen e sigurimit dhe për të klasifikuar lëndimet dhe shkallën e kompensimit për lëndimet e shkaktuara në punë.

Neni 9.

Mungesa në punë për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit

1 . Me vendim të organit të autorizuar shtetëror ose organit të autorizuar të punëdhënësit, për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i punësuarit ka të drejtën e mungesës me arsyë nga puna.

2. Gjatë mungesës së përkohshme në punë për shkak të pasigurisë në vendin e punës, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pagës të cilën do ta kishte realizuar sikur të kishte punuar, por jo më gjatë se dyzetepesë (45) ditë në vitin kalendarik.

Neni 10.

1. Secilit punëtor, me rastin e pagesës së pages, duhet t'i dorëzohet

1.1 llogaria me shkrim, e cila përmban së paku këto shënime:

1.2 pagën bazë të punëtorit,

1.3 pagën në bazë të suksesi t, /pjesa stimulative dhe destimulative në vler prej 10% të pagës bazë dhe në vlersim të menaxherit/,

1.4 pagën bruto,

1.5 vlerat e kontributave për sigurime shoqërore të obligueshme, ose formave të tjera të sigurimeve,

1.6 tatimi nga të ardhurat personale,

1.7 pagesa neto e pagës.

2. Me rastin e llogaritjes së pagës, punëdhënësi mund t'i llogarisë në të njëjtën fletë llogaritëse edhe të ardhurat e tjera personale, kompensimin e shpenzimeve në lidhje me punën si dhe zbritjen nga paga (pagesa neto).

3. Punëdhënësi në prani të punëtorëve bën kontrollimin e llogarisë së pagës dhe të kompensimeve si dhe jep shpjegim për të gjitha rrethanat në lidhje me llogarinë nëse këtë e kërkon punëtori ose përfaqësuesi sindikal në kërkasen e tij.

✓ vendi që tiflëzohet ka jashtë i dhënë par

✓ Këng e mesazhi është i dhënë që dëshmoj **Neni 11.**

Punëtori ka të drejtë, me rastin e pensionimit, në pagesën përcjellëse në lartësi të tri pagave mesatare të KUR."Hidrodrini" Sh.A.Pejë, për tre (3) muajt e kaluar.

Neni 12.

1 . Në rast të vdekjes së punëtorit, antarët të familjes së ngushtë të tij, kanë të drejtë në ndihmën solidare, në lartësi prej të tri pagave mesatare e të ardhurave personale të të gjithë punëtorëve në Kompani .

2. Anëtarët e familjes së ngushtë janë: bashkëshorti, fëmijët (martesorë dhe jashtë martese) si dhe të birësuarit të cilët punëtori është i obliguar t'i mbajë sipas ligjit dhe prindrit e punëtorit, në qoft se kanë jetuar në bashkësi familijare .

Kompensimin e shpenzimeve te udhëtimit zyrtar

Neni 13.

Punëtorve të Kompanisë, iu takon kompensimi i shpenzimeve për udhëtim zyrtar kur kryejnë pune ne kuadër te detyrave te tyre te punës për K. R. U " Hidrodrini" SH. A. Pejë.

Neni 14.

Kryeshefi ekzekutiv vendos për personat te cilët do te udhëtojnë zyrtarisht ne kuadër te projekteve ose nevojave te tjera qe paraqiten ne kuadër te afarizmit dhe politikave zhvillimore te K. R. U " Hidrodrini"SH.A. Pejë.

Neni 15.

U rdhëresa për udhëtim zyrtar duhet te përmban këto shënime:

- emri dhe mbiemri i punëmarrësit qe udhëton
- punët dhe detyrat e punës qe duhet te kryhen,
- vendi dhe shteti ku duhet udhëtuar,
- koha e nisjes dhe kohëzgjatja e udhëtimit,
- mjeti i udhëtimit qe do te përdoret për udhëtim,
- lartësia e akontacionit dhe te dhënët tjera eventuale te nevojshme.

Neni 16.

1.Në emër të shpenzimeve zyrtare, për ullëtime jashtë Kosovës punëtorit do ti paguhen, shpenzimet të cilat përfshijnë transportin , fjetjen dhe shujtat për udhëtime pune

Kompensimi i shpenzimit për fjetje;

Neni 17.

1. Fjetja jashtë Kosovës kompensohet sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike nr. MSHP 2004/07 që varet nga shteti ku behet fjetja.

Shpenzimet e transportit

Neni 18.

1. Shpenzimet e transportit të udhëtimit zyrtar kompensohen ne vlerën 100 % te shpenzimeve faktike të dëshmuara me biletat e transportit publik ose në formë tjetër.
2. Nëse punëmarrësi e shfrytëzon automjetin privat për udhëtim zyrtar i paguhet kompensimi te shpenzimeve te derivateve 0,16 € për kilometër

Kompensimi i shpenzimit për shujta jashtë Kosovës;

Neni 19.

1. Shujta jashtë Kosovës kompensohet sipas nenit 12 të U dhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike nr. MSHP 2004/07 që varet nga shteti ku janë siguruar ushqimet.

Neni 20.

1. Në baze te urdhëresës për udhëtim jashtë vendit mund te paguhet akontacioni ne lartësi te shpenzimeve te përllogaritura.
2. Llogaritjes se shpenzimeve te udhëtimit i bashkëngjiten:
 - a) Urdhëresa për udhëtim zyrtar dhe provat mbi shumen e paguar për shpenzimet e tërësishme te hotelit, biletës se udhëtimit, dhe shpenzimeve te tjera te pranueshme

Neni 21.

1. Në afat prej 48 orësh pas kthimit ne pune punëmarrësi duhet te paraqes raportin me shkrim për kryerjen e detyrave ne ketë udhëtim zyrtar.
2. Faturat për harxhime gjate udhëtimit duhet ti paraqes ne afat prej tri

ditësh.

Shpenzimet e sigurimeve mjekësore, vizave, thirrjeve telefonike

~~Adhura e vjetore makasore që nuk mund te kompenzojte me kompenzimin e punës së punonjës.~~

Neni 22.

Kur janë te domosdoshme shpenzimet të sigurimeve mjeksore, vizave dhe thirrjeve telefonike, ato bien ne barre te K. R. U "Hidrodrinii" SH.A. Pejë

~~Në këtë mënyrë do përfshihet kompenzimi i punës së punonjës, që nuk mund te kompenzojte me kompenzimin e punës së punonjës.~~

Neni 23.

~~Shpenzimet e kompenzimit të punës së punonjës, që nuk mund te kompenzojte me kompenzimin e punës së punonjës.~~

Punëtorit nuk do ta kompensohen shpenzimet e udhëtitimit për vajtje-ardhje ne punë.

Pjesmarrja ne seminare, kongrese e takime

Neni 24.

Shpenzimet e pjesmarjes në seminare, kongrese dhe takime, mund te kompenzohen vetem ne raste kur te njejtat organizohen ne kuader te lemit te ujit te pijes dhe kanalizimit apo sferave te peraferta

Neni 25.

1. Kompania mund t'i kompensoj shpenzimet e qiras per ndonjerin apo grupe te punemarresve per te cilet shprehet nevoja e theksuar e Kompanisë (kuadro).
2. Kete nevoje e percakton menaxhmenti i kompanise. Keto shpenzime mund te jene te perkoħħsħme dhe mund te zgħasim me se gjati 3 muaj.
3. Vlera maksimale per nje kest mujore te qiras mund te jete ne lartesine ne nje page mesatare mujore ne nivel te Kompanisë.

Shpenzimet për ndihma solidare financiare pa obligim kthimi

Neni 26.

- 1 . Ndihma solidare, pa obligim kthimi lejohet n e rast të fatkeqesise natyrore perkatesisht vdekjes se punëtorit apo anetarit te ngushte te familjes se punëtorit.
- (a) N e rast te vdekjes se punëtorit ndihma solidare percaktoh maksimalisht ne vleren prej 3 pagave mesatare në nivelin e Kompanisë.
- (b) N e rast te vdekjes se anetarit te ngusht te familjes se punitorit (bashkshortit/es dhe femijet) ndihma solidare maksimalisht nuk mund te kaloje vleren e 1 page mujore mesatare te Kompanisë.

Neni 27.

N e rast te smundjes se rende te punëtorit apo fatkeqesive natyrore a ne baze te kerkeses se te njejteve mund t'iu ipet pa kthim ndihma solidare financiare te cilën vlerë e percakton menaxhemeti i kompanise, varesisht nga rasti dhe gjendja financiare e ndermarrjes, por kjo nuk mund te kaloj me shume se 3 paga mujore mesatare në nivelin e Kompanisë.

Kompenzimi me rastin e festave të fundvitit, fetare dhe kombtare

Neni 28.


Varesisht nga gjendja financiare e kompanise dhe ne pajtim me vendimin e menaxhmentit te kompanise, mund tu ndahen mjete financiare me rastin e festave fetare, kombtare , festave te fundvitit dhe per rastin e pergaditjeve per fillim-vitin e ri shkollor.

Neni 29.

Kjo rregullore do te hyje ne fuqi me datën e aprovimit nga Bordi i Drejtoreve, dhe do te vleje deri sa te mos revokohet me nje rregullore tjeter per lemin e njeje.



Kryetari i Bordit të Drejtoreve



Shkelzen Hyseni, jurist i dipl.

**KOMPANIJA E UJËSJELLËSIT RAJONAL
SH.A.**

HIDRODRINI

Zyrat Qendrore
Rr. Gazmend Zajmi 5
Telefoni: +381 39 432355
Web: www.hidrodrini.com

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr.03/L – 111 për Ndryshimin dhe \Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 138 paragafi 2 të Ligjit Nr.02/L-123 mbi Shoqëritë Tregtare, Bordi i Drejtorëve të KUR "Hidrodrini" Sh.A. Pejë, me datën 23.09.2014, miratoi këtë:

VENDIM

MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES MBI KOMPENZIMIN E BENIFICIONEVE DHE TË ARDHURAVE TJERA TË PUNËTORËVE TË KUR "HIDRODRINI" Sh.A. PEJË

Neni 1

Në Rregulloren mbi Kompensimin e benificacionve dhe të ardhurave tjera të punëtorëve të KUR "Hidrodrini" SH.A.Pejë, ndryshohen dhe plotësohen neni 11 dhe 12.

Në nenin 11 të Rregullores mbi Kompensimin e benificacionve dhe të ardhurave tjera të punëtorëve të KRU " Hidrodrini " SH.A.Pejë fshihet teksti: "Punëtori ka të drejtë, me rastin e pensionimit, në pagesën përcjellëse në lartësi të tri pagave mesatare të KUR "Hidrodrini" Sh.A.Pejë, për tre (3) muajt e kaluar".

Në nenin 11 të Rregullores , shkruhet teksti i ri i ndryshuar: "Punëtori ka të drejte me rastin e pensionimit, në pagesën përcjellëse në lartësi nga dy pagat mesatare të Kompanisë, për tre (3) muajt e fundit, gjegjësisht dy paga mesatare të punëtorit për 3 (tre) muajt e kaluar, nëse për punëtorin kjo është më e përshtatshme".

Neni 2

Në neni 12 alinea 1 të Rregullores fshihet në tërësi teksti: "Në rast të vdekjes së punëtorit, antarët të familjes së ngushtë të tij, kanë të drejtë në ndihmën solidare, në lartësi prej të tri pagave mesatare e të ardhurave personale të të gjithë punëtorëve në Kompani ".

Në neni 12 alinea 1 shkruhet teksti i ndryshuar; "Në rast të vdekjes së punëtorit anëtarët e familjes kanë të drejtë në ndihmë solidare në lartësi nga dy paga mesatare të Kompanisë, për

tre muajt e fundit, gjegjësisht dy paga mesatare të cilat punëtori i ndjer i ka realizuar për 3 (tre) muajt e fundit, nëse për familjen kjo është më e përshtatshme .

Neni 3

Ky Vendim hyn ne fuqi pas marrjes së vendimit nga Bordi i Drejtoreve të KUR " Hidrodrini " Sh. A. Pejë , në pajtim me nenin 20 të Ligjit nr.04/L-111 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike .

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Bordi i Drejtoreve të KRU " Hidrodrini " SH.A.Pejë



Kryetari i Bordit të Drejtoreve
z.Shkelzen Hyseni (jurist i dipl.)

Me këtë vendim, KOMPAÑIA E UJËSJELLESIT RAJONAL " HIDRODRINI " SH.A. PEJE, i cili ka qenë drejtuar që t'i dërgojë një paga mesatare të cilat punëtori i ndjer i ka realizuar për 3 (tre) muajt e fundit, gjegjësisht dy paga mesatare të cilat punëtori i ndjer i ka realizuar për 3 (tre) muajt e fundit, nëse për familjen kjo është më e përshtatshme .

Me këtë vendim, KOMPAÑIA E UJËSJELLESIT RAJONAL " HIDRODRINI " SH.A. PEJE, i cili ka qenë drejtuar që t'i dërgojë një paga mesatare të cilat punëtori i ndjer i ka realizuar për 3 (tre) muajt e fundit, gjegjësisht dy paga mesatare të cilat punëtori i ndjer i ka realizuar për 3 (tre) muajt e fundit, nëse për familjen kjo është më e përshtatshme .

Neni 5

Me këtë vendim, j'vih agjiva: " Nihet ne terren teknik " Në këtë terren teknik, i cili ka qenë drejtuar së ngushje të 01, komët të drejtë në ndihmën e qendrave, që përfshijnë: " Të ardhura e të ardhurave personale që të gjithë punëtorët që përfshijnë "

Me këtë vendim, j'vih agjiva: " Në këtë terren teknik, i cili ka qenë drejtuar së ngushje të 01, komët të drejtë në ndihmën e qendrave, që përfshijnë: " Të ardhura e të ardhurave personale që të gjithë punëtorët që përfshijnë "